

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-Vlada KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË	
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE	
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY	
SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jednica Org Unit	018
Nr. Prot: Broj Prot: Prot. No:	2178
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	2
Date:	29, 06, 20 17
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku
i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Prishtinë, më 29 qershor 2015
Ref. nr. 260/018

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të neneve 92 dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenet 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010), nenin 8 (1.4) dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare, Nr. 1, 18 prill 2011), nenin 6, paragrafi 1, pika 1.13 të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare nr. 14, 9 shtator 2011) dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 12/2007 (11.10.2007), nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Unifikohen pagat dhe shtesat e kryetarëve/kryesuesve dhe anëtarëve të Këshillave Drejtuese të të gjitha institucioneve publike të arsimit të lartë dhe instituteve kërkimore-shkencore publike, që financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, si në vijim:
 - 1.1. Kryetarët/Kryesuesit të zgjedhur apo emëruar në Këshillat Drejtues të të gjitha institucioneve publike të arsimit të lartë, për punën e tyre ju takon paga mujore 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro në muaj dhe shtesa prej 30 (tridhjetë) euro për çdo mbledhje.
 - 1.2. Anëtarët të zgjedhur apo emëruar në Këshillat Drejtuese të të gjitha institucioneve publike të arsimit të lartë, për punën e tyre ju takon paga mujore 200 (dyqind) euro në muaj dhe shtesa prej 25 (njëzetë e pesë) euro për çdo mbledhje.
 - 1.3. Kryetarët/Kryesuesit të zgjedhur apo emëruar në Këshillat Drejtuese të të gjitha instituteve kërkimore-shkencore publike, për punën e tyre ju takon paga mujore 200 (dy qind) euro në muaj dhe shtesa prej 30 (tridhjetë) euro për çdo mbledhje.

- 1.4. Anëtarët të zgjedhur apo emëruar në Këshillat Drejtuese të të gjitha instituteve kërkimore-shkencore publike, për punën e tyre ju takon paga mujore 150 (njëqind e pesëdhjetë) euro në muaj dhe shtesa prej 25 (njëzetë e pesë) euro për çdo mbledhje.
- 1.5. Zëvendëskryetarët/Zëvendëskryesuesit për takimet e punës që e zëvendëson kryetarin/kryesuesin e realizojn pagën/shtesën e përcaktuar për kryetarin/kryesuesin sipas pikës 1.1 dhe 1.3 të këtij vendimi.
2. Shtesat e përcaktuara sipas pikës 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të këtij vendimi, do të bëhet për jo më shumë se 4 (katër) takime në muaj, me përjashtim të rasteve të mbledhjeve të jashtëzakonshme.
3. Pagat dhe shtesat e përcaktuara sipas pikës 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të këtij vendimi, do të paguhen nga buxhetet përkatëse të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe instituteve kërkimore-shkencore publike.
4. Obligohen të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë dhe institutet kërkimore-shkencore publike t'i harmonizojnë aktet e tyre nënligjore me këtë vendim, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
5. Obligohen autoritetet kryesore menaxhuese të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe instituteve kërkimore-shkencore publike për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim shfuqizon të gjitha aktet juridike në fuqi të nxjerra nga organet e institucioneve publike të arsimit të lartë dhe instituteve kërkimore-shkencore publike, në të cilat është përcaktuar paga dhe shtesa e kryetarit/kryesuesit dhe anëtarëve të zgjedhur apo të emëruar në Këshillat Drejtues të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe instituteve kërkimore-shkencore publike.
7. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Arsim BAJRAMI

Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Vendimi ju dërgohet:

- Të gjitha institucioneve publike të arsimit të lartë;
- Të gjitha instituteve kërkimore-shkencore publike;
- Ministrisë së Administratës Publike (ministrit);
- Ministrisë së Financave (ministrit);
- Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
- Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, MASHT;
- Arkivit të MASHT.